



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr./Br. 79/22
Date/Datum. 19.04.22

PRISHTINË - PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh. nr. 79/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Pro Medical” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe material mjekësor –Kontrate 36 muajsh ose 3 vite me material stomatologjik” me numër të prokurimit 642-21-5980-1-1-1, iniciuar nga AK- Komuna Mitrovicë e Jugut-për **Grup 2**, të iniciuar nga AK – Komuna Mitrovicës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 15 prill 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “Pro Medical” me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 79/22, 29 mars 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me barna dhe material mjekësor –Kontratë 36 muajsh ose 3 vite me material stomatologjik” me numër të prokurimit 642-21-5980-1-1-1, iniciuar nga AK- Komuna Mitrovicë e Jugut-për **Grup 2**, të iniciuar nga AK – Komuna e Mitrovicës.

- II. ILEJOHET,** autoritetit kontraktues – Komuna e Mitrovicës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me barna dhe material mjekësor –Kontrate 36 muajsh ose 3 vite me material stomatologjik” me numër të prokurimit 642-21-5980-1-1-1.
- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në sistemin elektronik me datë 29 mars 2022, ka pranuar ankesë nga OE “Pro Medical” me seli në Prishtinë, ankesa ndërlidhet me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me barna dhe material mjekësor –Kontratë 36 muajsh ose 3 vite me material stomatologjik” me numër të prokurimit 642-21-5980-1-1-1.

Operatori ekonomik “Pro Medical” me seli në Prishtinë, me datën 21.03.2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kundër vendimit të AK-së të datës 18.03.2022 ***për heqje të pezullimit automatik.***

Ankesa e parashtruar në OSHP me datën 29 mars 2022 nga operatori ekonomik “Pro Medical” me seli në Prishtinë për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me barna dhe material mjekësor –Kontratë 36 muajsh ose 3 vite me material stomatologjik” me numër të prokurimit 642-21-5980-1-1-1, iniciuar nga AK- Komuna Mitrovicë e Jugut-për **Grup 2**, është parashtruar kundër **vendimit për heqje të pezullimit automatik të këtij aktivitetit të prokurimit**, dhe nuk është parashtruar kundër një vendimi të autoritetit kontraktues sic është:

Njoftimit për Kontratë, Njoftimit për Dhënie të Kontratës/ Letër Standarte e as Njoftim për Anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë ashtu sic parashihet në nenin 108/A të LPP-së si dhe në nenin 4 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së.

Pra, në pajtim me nenin 108/A të LPP-së dhe sipas nenit 4 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera të tarifave të ankesave palët kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe ankesë në OSHP vetëm kundër vendimeve të AK-së: **Njoftimi për kontratë, Njoftimi për dhënie të kontratës/ Letër standarte dhe Njoftimit për Anulim të aktivitetit të prokurimit**, ashtu sic është paraparë në këto dispozita ligjore brenda afatëve kohore, andaj duke u bazuar në këtë, vlerësojmë se ankesa e parashtruar në OSHP duhet të hedhet si e palejuar ndërkaq pala mund të drejtohet gjykatës kompetente për veprimet e autoritetit kontraktues e që OSHP nuk mban përgjegjesi.

Duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE “Pro Medical” me seli në Prishtinë, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së si dhe nenin 4 të Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, andaj e njëjta nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Mitrovicës
- 1x1 OE-“Pro Medical” me seli në Prishtinë
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në çeb- faqe të OSHP-së

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

z. Ardian BEHRA

